

V E N D I M
Nr.419, datë 7.8.1995

**PËR RAPORTIMIN E PËRDORIMIT TË KREDIVE TË MARRA NGA QEVERIA E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETI SHQIPTAR PREJ INSTITUCIONEVE DHE
ORGANIZATAVE TË TJERA NDËRKOMBËTARE**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Të gjitha njësitë e zbatimit të projekteve të ndryshme pranë ministrive, institucioneve qendrore dhe organeve të pushtetit lokal, që financohen me kredi të amrra nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose shteti shqiptar prej institucioneve ose organizatave ndërkombëtare, të raportojnë për datën e tërheqjes shumë e tërhequr dhe pjesën e papërdorur të kredive në datën 5 të çdo muaji pranë Ministrisë së Financave.

2.Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë brenda datës 5 të çdo muaji duhet të raportojnë pranë Ministrisë së Financave tërheqjet, pagesat sipas datave përkatëse si dhe pjesën e papërdorur të kredive të ndryshme të marra nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose shteti shqiptar prej institucioneve ose organizatave të ndryshme ndërkombëtare.

3.Raportimet sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi të fillojnë nga data 1.4.1995.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi